



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.05.2019, ora 10:00

Drejtojnë mbledhjen:

Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i axhendës së punës së komisionit në vazhdim.

Marrin pjesë:

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj dhe Ralf Gjoni.

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjikhuri – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Siç ramë dakord edhe herën e kaluar, është mirë që, këtej e tutje, mbledhjet t'i zhvillojmë pa praninë e medias, në mënyrë që të jenë edhe më produktive.

Nga diskutimi që patëm mbledhjen e kaluar me bashkëkryetaren ramë dakord që, meqenëse pjesa e kalendarit nuk mori miratimin final dhe ju kërkonit më shumë kohë për t'u konsultuar, pra një pjesë e përfaqësuesve të opozitës, le ta rishikojmë sot kalendarin, në mënyrë që të bëjmë miratimin final.

Kalendarin e keni përpara. Bashkëkryetarja dhe unë kemi bërë një propozim që, përtej asaj që thashë radhën e kaluar, mund ta çojmë më 30 korrik diskutimin e rekomandimeve të ODIHR-it, le të zhvillohen edhe zgjedhjet, se mund të dalin problematika, të cilat kemi nevojë t'i adresojmë.

Mendoj se kjo datë është më e përshtatshme, pra le të marrë edhe një muaj më shumë, pavarësisht se një produkt është i gatshëm nga komisioni paraardhës, i cili mirë është të shpërndahet (me sa shoh është shpërndarë), që të filloni edhe ju ta konsultoni, përpara se të vendosim për miratimin ose jo të propozimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Pra, propozimi im është që diskutimi, lidhur rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet, në vend të muajit qershor, që e kisha propozuar në fillim, të shtyhet në datën 30 korrik të vitit 2019.

Besoj se edhe ju ishit dakord në atë kohë që të marrim më shumë kohë, por, mbi të gjitha, në fokus, le të kalojnë edhe zgjedhjet, sepse, në fakt, që tani kanë dalë gjëra qoftë për shkak të bojkotit të opozitës, qoftë të situatave të reja ligjore, që ne duhet t'i parashikojmë mirë në Kod, në mënyrë që të evitojmë çdolloj keqinterpretimi në të ardhmen.

Unë këto kisha.

Nëse ka ndonjë diskutim nga kolegët rreth aspekteve që fola, hajdeni t'i diskutojmë. Në të kundërt, do të propozoja që ta miratonim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Murrizi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hajdari, keni ndonjë gjë për të shtuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Të nderuar kolegë dhe bashkëkryetarë të Komisionit të Reformës Zgjedhore,

Unë do të doja të depozitoja në këtë komision një kërkesë, në emër të 38 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, që është marrë këto dy ditë me firma, ku kërkohet t'i jepet prioritetet pikës së tretë të kaluar: “ndryshimi i sistemit zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, për rrjedhojë ndryshimeve kushtetuese...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pika e katërt? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithashtu, kërkojmë të organizohet një tryezë e gjerë ndërmjet forcave të ndryshme politike dhe shoqërisë civile për të mbledhur opinione më të gjera rreth kësaj çështjeje shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me funksionimin e parlamentarizmit dhe zgjedhjen e deputetëve si përfaqësues të qytetarëve shqiptarë.

Doja ta depozitoja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, shikojeni, mban 38 firma të deputetëve të opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Zoti Murrizi, nuk kam asgjë kundër kësaj kërkesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, do të shpërndahet kjo, pasi të depozitohet në sekretari, unë thjesht e mora në administrim për momentin.

Pra, çështja e reformës në sistemin zgjedhor, pavarësisht se është pika e katërt në renditje, është pjesë integrale e këtij komisioni. Në qoftë se ju keni një ide ose propozim konkret që ne të organizojmë një tryezë, jam dakord në parim, jua lë këtë nismë... Nuk shoh ndonjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, i gjithë komisioni.

Siç po thosha, jam dakord në parim, por e mira është që në ditët në vijim të kemi edhe një koncept të qartë se si do ta organizojmë këtë tryezë. Pra, të mos e kthejmë në një tryezë të thjeshtë, ku të gjitha partitë politike të japin mendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk them që do ta vendosim sot, por ta diskutojmë edhe kohën kur do ta organizojmë. Pra, mund të miratojmë këtë, krahas kalendarit. A mund të themi që brenda korrikut të vitit 2019 komisioni do të organizojë një tryezë me pjesëmarrjen e gjerë të të gjitha partive politike dhe faktorëve të tjerë të interesuar? Biem dakord ta organizojmë brenda korrikut?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Tryezë të rrumbullakët për sistemin zgjedhor?

Unë do të sugjeroja, duke marrë shkas edhe nga kalendarit ose plani i punës së komisionit, të kishim një kalendar të mirëfilltë pune (me data, me javë të sakta dhe me tema të paracaktuara, që do të diskutohen gjatë atyre javëve).

Mendoj se do të isha në favor, në fakt, sa më shpejt të një tryeze të rrumbullakët me partitë politike ose edhe me përfaqësues të shoqërisë civile për sa i përket sistemit zgjedhor, pra jo brenda korrikut, por më mirë brenda qershorit. Madje, personalisht do të isha në favor të organizimit të një tryeze të rrumbullakët brenda dy-tri javëve të ardhshme, të jetë konsultative, duke qenë se japim edhe një mesazh politik. Mendoj se edhe ju, si maxhorancë, të jepni një mesazh që do ta fusni këtë pikë kaq të rëndësishme në diskutimin e komisionit.

Damian Gjijnuri – Zoti Gjoni, kjo pikë është e rëndësishme, ndaj mos e zhvlerësoni si pikë për nga renditja.

Një nga objektivat kryesorë dhe të punës së këtij komisioni është çështja e reformës së sistemit zgjedhor. Shtrohet pyetja: pse kërkon më shumë kohë? Sepse është *sui generis*, është një gjë nga e para, për të cilën ne nuk kemi një model dhe, siç me të drejtë u tha, do diskutim nga shumë aktorë, plus pritet një ekspert i OSBE-së. Unë kam folur me ambasadorin, i cili do të vijë shumë shpejt dhe do të zhvillojë takime në Shqipëri me të gjithë aktorët e interesuar për ta trajtuar këtë temë.

Tani, për të qenë praktikë, nga pikëpamja e kalendarit, nuk mund të vendosësh kalendar javor. Ne kemi vënë çështjet kryesore, të cilat do të detajohen rast pas rasti. Pra, ne do të mblidhemi për një, dy, tre nga këto pika, kur të kemi një produkt të gatshëm. Ne nuk kemi pse t'i lidhim duart me një kalendar të detajuar, sepse nuk ka ndodhur ndonjëherë në Komisionin e Reformës Zgjedhore, pra nuk e merr njeri përsipër që në javën e tretë do të diskutohet iks çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, kanë rezultate. Nuk është reforma e parë, janë bërë disa të tilla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është tjetër gjë nëse ju kanë pëlqyer ose jo rezultatet, por rezultatet kanë dalë.

E dyta, jam dakord, madje unë them ta hedhim edhe në votim, sepse të gjithë mund të kemi mendime të ndryshme, por mendoj se në korrik është periudha më e mirë. Pse? Të kalojnë edhe zgjedhjet vendore. Ka edhe një qartësi në lidhje me horizontin e ri politik pas zgjedhjeve vendore, ndaj unë them që korriku është muaji i duhur për ta hapur këtë tematikë, pasi shumë aktorë politikë do të reflektojnë nga situatat e reja politike. Gjithsesi, ky është mendimi im. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë mendim tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Mund të them edhe unë dy fjalë për ato që tha zoti Gjoni. Mendoj se tryeza është fillimi i procesit, por kjo nuk do të thotë se mblidhet tryeza dhe zgjidhet çdo gjë, sepse mund të mblidhet tryeza, por edhe të rimblidhet. Pra, do të ketë disa faza, sepse do të arrihen disa përfundime. Nuk është se do të dalim në përfundimin që do ta ndryshojmë ose jo sistemin.

Tryeza është konsultim dhe diskutim publik. Ne duhet të mendojmë cilët aktorë do të ftojme, kush do të jetë prezent dhe si do ta zhvillojmë këtë diskutim. Pra, të mos merremi vetëm me takimin dhe datën, por të shohim edhe produktin se si do ta arrijmë këtë objektiv.

Mendoj se kjo tryezë nuk do të bëhet vetëm në një ditë, por do të ketë disa mbledhje. Kështu, nuk kemi pse të merremi thjesht se në cilin muaj, por le të fillojë sa më shpejt. Përderisa janë 38 deputetë firmëtarë të kësaj deklarate, mendoj se duhet të trajtohet me prioritet, se 38 deputetë nuk janë pak, madje mund të bëjnë ndryshime kushtetuese. Për këtë mund të flasin ata që janë këtu ekspertë ligjorë dhe që e njohin mirë Kushtetutën. Pra, mendoj se duhet ta trajtojmë me seriozitet këtë kërkesë, pasi është firmosur nga 38 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Ne mund ta flasim si bashkëkryetarë se kur do të zhvillohen këto takime, por nuk kemi pse të druhemi: qershor apo korrik, pra kur të jetë mundësia më e parë e mundshme, por ta ndajmë në disa faza, sepse, siç e thashë, duhet të mendojmë kush do të ftohet, si do ta zhvillojmë diskutimin dhe si do të arrihen përfundimet. Pastaj, ne si komision do ta zhvillojmë më tej si temë, se ku do të dalim ne, kush është sistemi më i përshtatshëm i mundshëm. Sepse të gjitha sistemet kanë hapësirë për diskutim.

Ky është mendimi im, por mund ta shtrojmë për diskutim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Faleminderit, të nderuar bashkëkryetarë!

Unë mendoj që duhet të jemi racionalë, sepse, vërtet përfaqësojmë parti politike këtu, unë e kam thënë edhe herë të tjera, por do të bëjmë, së pari, edhe rolin e teknikienit, në mënyrë që nga kjo tryezë të prodhohet rezultat.

Ne duhet të kuptojmë që, pavarësisht dëshirave personale tonat, produkti që do të jetë, do të jetë konsensual, që do të përpiqet të arrijë më të mirën e të gjithëve.

Nëse do të fillojmë të imponohemi që tema, pavarësisht se është renditur e katërta, mund të jetë më e rëndësishme, por ka afatin më të gjatë nga të gjitha pikat në grafikun që do të miratojmë, të fillojmë e ta miratojmë në mesin e fushatës elektorale. Por, mos harroni, kolegë, se ne jemi të fokusuar në fushatë. Ndoshta ndonjëri prej jush nuk e ka këtë prokopi, ndërkohë që ne e kemi.

Vetë Partia Socialiste, unë (si deputet i saj) dhe secili nga kolegët tanë do të jetë në fushatë. Nuk është prioritet yni të vendosim në mes të fushatës për sistemin zgjedhor, qoftë edhe ta nisim diskutimin, ndërkohë që vetë jeni tërësisht të paqartë se si do të bëhet diskutimi, cilët do të ftojme, cilët ekspertë, si do të ndërtohet tryeza. Sapo e tha edhe bashkëkryetarja se do të duhet që ta përcaktojmë këtë gjë. Prandaj, le t'u lëmë kohë gjërave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, nuk do t'i bëjmë rrëmujë, do t'i bëjmë të pjekura!

Vërtet janë 38 deputetë, por nuk e ndryshojnë dot Kushtetutën; mund të iniciojnë ndryshimet kushtetuese!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Kush po e mohon?! Nuk po e mohon njeri. Ky është fakt i padiskutueshëm, por kjo nuk na nxit të bëjmë rrëmujë.

Mbarojmë zgjedhjet dhe pastaj në korrik do të jemi më të lirë nga çdo axhendë, por edhe veprimtaria e parlamentit është pak më *slow*, nuk ka intensitet të lartë të punëve. Ndaj ne do të fokusohemi pikërisht te kjo çështje. Kemi mbyllur edhe fushatën, mund të kenë dalë disa problematika, që do t'i bashkëngjiten pikës 1, që do të na i rendisë OSBE-ODIHR-i, do të diskutojmë edhe pikën 1, bëjmë edhe një tryezë të posaçme dhe, kështu, nisim diskutimin për pikën 4.

Se kur do të nisë, e nisim në korrik, i lëmë kohë ftesës së ekspertëve të ndryshëm dhe ju garantoj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam bërë një studim: kam marrë pjesë në konferenca për çështjen e sistemit elektorale dhe ju them se është shumë i komplikuar. Ndonjëri flet me kompetenca dhe thotë:

ky sistem është më i miri. Në fakt, një sistem, që prodhon dhjetë të mira, prodhon edhe dhjetë të këqija automatikisht; bashkëshoqërojnë njëra-tjetrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj, më mirë të bëjmë një gjë që, po të duam ta prekim dhe të bëjmë një ndryshim sistemi, të bëjmë një sistem që, pas katër vjetësh, të mos ulemi përsëri në këtë tryezë ne ose ata që do të jenë, se mund të mos jemi ne, dhe të diskutojmë nga e para. Prandaj ta marrim qetë, ta miratojmë si grafik të përgjithshëm dhe këtu jemi.

Bashkëkryetarët kanë një rol të rëndësishëm. Ata do të ndërtojnë një axhendë më të ngjeshur sipas situatave, sipas rekomandimeve të partnerëve, sepse ne duhet të ecim në të njëjtën linjë me partnerët.

Se t'i marrim për prift, tani nuk mund t'u rruajmë mjekrën. Ndaj, unë sugjeroj ta miratojmë grafikun siç është, që, në mos gaboj, ka qenë edhe i dakordësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por të mos rrimë të ngurtë dhe të themi: duhet ta nisim menjëherë në qershor. Le t'i lëmë kohë vetes dhe të qartësohemi. Ju garantoj se reformimi i sistemit zgjedhor është një temë shumë delikate.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Për kompromis dhe për thjeshtësi, për ta ngushtuar bisedën, jo se dua ta mbyllim, e mira është të jemi edhe racionalë, se kjo mbledhje pune është. Unë them që ne mund ta vendosim deri në korrik; mund të ndodhë edhe në qershor, edhe në korrik. Pra, të marrim pak kohë.

Komisioni i Reformës Zgjedhore, pra me propozim e kështu, e vë te ky kalendar që do t'i fillojë diskutimet nëpërmjet një tryeze, prandaj në korrik duhet të zhvillohet tryeza e parë me pjesëmarrjen e aktorëve politikë dhe palëve të tjera të interesuara, sipas përcaktimit që do të bëjë komisioni.

Edhe atë në dorë e kemi, e bëjmë në qershor, se edhe në qershor mund të ketë ngjarje, që as ju nuk do t'ua keni ngenë. Këtë po them.

Ralf Gjoni – A mund të bëj një replikë të vogël?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po flasim kot, jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Jo, jo, Alket!

Unë e kuptoj që ju jeni në fushatë, në fakt, se e njëjta gjë do të ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e vë fare në dyshim, por...

(Diskutime në sallë)

Zoti Hyseni, ndoshta edhe për situatën politike, edhe për ju, edhe për vetë maxhorancën, besoj unë, që një tryezë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Flasim me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Meqenëse e propozova, unë mendoj...

(Diskutime në sallë)

E kuptoj që keni fushatë, nuk bëhet fjalë për këtë, sepse kam qenë në fushatë prej 29 vjetësh, por besoj se ndoshta në këtë situatë nuk do të kishte asgjë të keqe të organizohej një tryezë edhe gjatë mesit të fushatës, gjatë këtij tensioni dhe këtij kulmi, që të ulëshin të gjithë ata që janë... Madje besoj se edhe për ju, si maxhorancë, do të ishte e mira të bëhej një inicim nga ky komision, qoftë edhe për të testuar ato letrat që po çojnë: “1, 2, 3, 4”, që të shikojmë se kush e do me gjithë mend, se i dëgjojmë deklaratat që bëhen ca në Durrës, ca në Tepelenë, ca në Kryevidh, ca të tjera në Gosë, që jemi dakord për çdo gjë, vetëm të bëhet më e mira. Atëherë, nga ky komision t’u shkojë ftesa për t’i parë. Pastaj, kemi njëfarë të drejte ne, opinionin dhe të gjithë ata që merren me këtë punë, t’u themi: ore, ju u tallkeni në takimet që bëkeni me miletin? Atëherë, nuk u dashka ky ndryshim!

T’ua bëjmë ftesën sa më shpejt, se një orë punë është.

Unë e di që jeni në fushatë, por edhe aq të angazhuar nuk jeni, sepse nuk keni gjë përballë. Po të ishte që do të kishit përballë një fushatë agresive, në sensin e mirë, do të shkoje katund më katund. Unë them t’u çojmë një ftesë PD-së, LSI-së, rrugores, jorrugores e çfarë janë, të gjithëve me radhë. Le të jenë 60 parti dhe i provojmë, meqenëse është kjo fushatë.

(Diskutime në sallë)

Kaq kisha.

Vasilika Hysi – Faleminderit, bashkëkryetarë!

Unë kam një pyetje që ndikon edhe te data: a është i gatshëm eksperti për një periudhë prej dy javësh? Sot jemi në fund të muajit maj. Të përgatisësh një konferencë ose tryezë ndërkombëtare me të gjitha përkatitjet, siç duhet, ku minimumi një javë përpara partitë

pjesëmarrëse duhet ta kenë ftesën, duhet të jenë të përgatitura, se eksperti ka axhendën e tij. A është i gatshëm ai të vijë, përveç të gjithë ngarkesës që ne kemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam për zotin Gjoni.

E dyta, në qoftë se ne e zhvillojmë tryezën në mes të qershorit, a e kemi vëmendjen e duhur? Sepse është një periudhë shumë e ngjeshur, jo vetëm me fushatën, por, siç duken gjasat, do të ketë ecejake, delegacione, do të vijnë ekspertë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbarojnë zgjedhjet në Parlamentin Europian për dy-tri ditë dhe besoj se vëmendja do të kthehet te ne. Atëherë, a mendoni që ajo tryezë të bëhet për dy javë? Javën e tretë nuk e bën dot, javën e katërt, po ashtu. A nuk mendoni se do të jetë e papërgatitur, sa duhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte në formë pyetjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Për ta sqaruar...

Damian Gjoknuri – Më falni, kush është ai zotëria?

Jeni deputet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngaqë këtu rrinë anëtarët e komisionit dhe më bëri përshtypje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, kur të bëhesh.

Normalisht, ja edhe një koleg i nderuar, më i vjetër sesa ty, por... Kije parasysh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, por normalisht këtu rrinë anëtarët e komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të qenë racionalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ia vlen, do të humbim kohë kështu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Vasilika, t'jua sqaroj, pasi kam përshtypjen që po flasim për dy gjëra të ndryshme.

E para, puna e partnerëve më duket pak si teknikë ose taktikë për të zgjatur...

Një minutë, se nuk po flasim për tryezë ndërkombëtare!

Ne nuk na duhet një ekspert ndërkombëtar në këto momente për të filluar nga dëgjesat me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile ose grupet e interesit për sa i përket sistemit zgjedhor. Asnjë ekspert i BE-së, i OSBE-së ose Këshillit të Europës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përmendi edhe zoti Hyseni, por do të më lejoni t'ju drejtohem me emër për të mënjanuar formalizmat.

Ideja është e tillë: çfarë na pengon që të biem dakord për një kalendar të qartë për të gjitha javët? Sinqerisht, nuk e kuptoj këtë që thotë Damiani: “Nuk kemi punuar ndonjëherë kështu me kalendar të qartë”. Të bëjmë një kalendar të qartë dhe fillojmë që javën që vjen me përgatitjet e dëgjesave, që duhet të bëjmë me aktorë të ndryshëm të grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile. Për shembull, ka një grup shumë të madh të shoqërisë civile që ka filluar mbledhjen e firmave në terren, të cilët kanë dëshirë të dëgjohen dhe të shprehin mendimet e tyre në këtë komision.

Pra, Vasilika, nuk kemi nevojë për asnjë ekspert ndërkombëtar për momentin. Kur të vijë puna për organizimin e një tryeze të madhe gjithëpërfshirëse konsultative, e bëjmë duke ftuar edhe ekspertë të huaj. Nuk do të na tregojë tani eksperti i huaj se çfarë sistemi na duhet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Ndjesë, se ju mora radhën!

Atëherë, për sa kohë ne kemi në të gjitha pikat e axhendës që do të diskutohen, fakti i një tryeze me partitë për të diskutuar për sistemin nuk është një gjë që do ta zgjidhim thjesht duke i thirrur, pasi do kohën e vet për t'u organizuar. Kemi qenë një pjesë e mirë pjesëtarë edhe e komisionit të mëparshëm të reformës zgjedhore, kemi dëgjuar dhe lexuar të gjitha propozimet e partive, kemi organizuar disa tavolina me të gjitha partitë e regjistruara në Shqipëri dhe në fund nuk kemi dalë me një përgjigje ndryshe nga ajo që kemi. Problematika e zgjedhjeve në Shqipëri nuk është vetëm sistemi, sepse sistemi është një nga problematikat. Pasi të merremi me pjesën e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, të merremi edhe me përcaktimin e datës, se kur do të jetë tryeza e konsultimit me partitë e tjera këtu.

Besoj se ne duhet të arrijmë konsensus brenda korrikut, siç e tha edhe bashkëkryetari, dhe të gjejmë kohën e duhur. Unë mendoj se kjo është mënyra më e mirë pa përcaktuar një datë, nëse duhet të jetë brenda qershorit apo brenda korrikut. Nëse arrijmë ta realizojmë përpara shumë mirë, por duhet të themi diçka: të mos vendosim data të cilat e dimë që nuk do t'i realizojmë dot.

Bashkim Fino – Do të jap një ide, meqë jam më i vjetër dhe kam marrë pjesë në shumë komisione. Çfarë është programi që bëjmë ne? Orientues. Nuk po bëjmë një program, që, në mënyrë absolute, po lëvizëm një datë apo 15 ditë nga muaji përkatës, do të bëhet nami. Pra të kemi pak më shumë besim te bashkëkryetarët tanë. Ndaj kemi bashkëkryetarë të cilët duhet të rakordojmë shumë gjëra me njëri-tjetrin, vijmë këtu për të na paraqitur një material dhe ne pak a shumë biem dakord. Pra ata të dy duhet të kenë të drejtën për të rakorduar më mirë datat, mundësinë dhe organizimin, siç tha dhe Vasilika, pasi ka vështirësi. Nuk po them për vështirësinë e organizimit, le ta bëjnë ata të dy dhe më shpejt një tryezë të tillë, nuk ka asnjë problem për mua, në daç ta bëjnë në qershor në daç brenda muajit maj. Pra, kalendari është orientues dhe ne e miratojmë sot.

Kam vërejtje për zotin Murrizi, nëse ka një iniciativë me 30 deputetë, minimalisht duhet ta kemi edhe ne që jemi komision, se është e drejta e tij që 38 deputetë, kanë firmosur dhe kanë paraqitur një material, të cilin ne nuk e kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, por ç'ëndësi ka? Minimalisht duhet ta marrim ne një herë, si anëtarë të komisionit, ta shohim, të vijmë në mbledhjen e radhës pas një jave, të themi dy gjëra për atë draft dhe të vendosim si do të bëjmë, do të organizojmë tryezë apo jo. Pra, ai e propozoi sot dhe, në momentin që unë e kam në tryezë, megjithëse nuk e kam, kam vetëm agjendën, atëherë edhe unë jam i përgatitur.

E fundit që kam është që ne pasi të miratojmë programin në parim, i cili është një program orientues, t'u lëmë më shumë hapësirë të dy bashkëkryetarëve që të vendosin për disa gjërat teknike. Mund të ndodhë që në këtë program të mos jetë miratuar ndonjë gjë dhe ata thërresin mbledhjen e komisionit, kurse ne do të mblidhemi në një moment të caktuar, se nuk kemi pse t'u themi "Plaç, nuk do të mblidhemi", duke pasur parasysh agjendën politike. Siç keni ju axhendë politike, pavarësisht se disa e quajnë të pavarur e disa të PD-së, kemi edhe ne. Kështu që unë mendoj ta miratojmë këtë axhendë në parim dhe t'u lëmë më shumë hapësirë bashkëkryetarëve të vendosin për gjëra më konkrete, por ndërkohë duam materialin nga kolegët tuaj, që ta kemi e ta shohim, sepse diskutimi për sistemin do të jetë i gjatë. Nuk është problem për ta hapur si diskutim, por ne nuk mund ta zgjidhim dot me një mbledhje, pasi hapet, ai do të diskutohet e do të dëgjohej.

Një gjë të fundit që kam dua ta kemi parasysh të gjithë; ta kuptoni që, kur miratohet një komision bipartizan as ju nuk bëni dot gjë vetëm e as ne. Kjo do të thotë se nëse do të dalë një draft nga ky komision bipartizan, do të shkojë me konsensus për t'u miratuar në

parlament, sepse mund të dalë një mendim tjetër nga dikush për një nen të caktuar, apo një mendim nga unë dhe kështu nuk miratohet asgjë. Kështu që të gjejmë mundësinë e një konsensusi për ta bërë vërtetë, draftin mbi bazën e vërejtjeve dhe sugjerimeve që ka bërë OSBE/ODIHR-i apo të gjërave të tjera që duam të fusim në të. T'u lëmë më shumë hapësirë dhe besim bashkëkryetarëve për të rakordua për shumë gjëra, me qëllim që, kur të vijmë këtu, të kemi një draft përpara, të diskutojmë mbi të dhe jo të themi pse nuk e bëmë këtë apo atë mbledhje. Këtë e them thjesht për të orientuar. Le ta miratojmë këtë në parim dhe t'u japim mundësinë dy bashkëkryetarëve të vazhdojnë më tej.

Faleminderit!

Damian Gjijnuri – A ka ndonjë gjë konkrete Nimet?

Nimet Musaj - Faleminderit, zoti Kryetar!

Duhet të nisem nga parimi. Po mblidhemi pas 10 vjetësh dhe kemi një barrë të rëndë përsipër për të ndryshuar sistemin dhe Kodin Zgjedhor. Një koleg këtu tha që normalisht nuk duhet të mblidhemi pas 4 vjetësh dhe t'i ktheheni prapë këtij sistemi. Kolegët e kanë eksperiencën, jam absolutisht dakord që ju si bashkëkryetarë duhet të vini me një program përpara dhe ne jemi gati të japim mendimet tona për gjithçka, për të bërë më të mirën e mundshme.

Faleminderit!

Damian Gjijnuri – Të ecim përpara me mirëkuptim. Në parim gjërat kështu funksionojnë, pra produktet do të përpunohen nga ekspertët, disa gjëra do t'i diskutojmë me bashkëkryetarin dhe ky është kanali juaj i diskutimit të brendshëm. Siç ulem unë me anëtarët e grupit tim apo me strukturat e mia, ashtu dhe ju keni zgjedhur bashkëkryetaren, e cila ju koordinon me qëndrimet. Realisht produkti i parë është edhe rishikimi i këtij programi, që do të thotë se jeni ulur për të gjetur një konsensus. I dyti është elementi që do të dalë më pas është një mesazh politik, sepse ky komision është edhe politik. Zoti Murizi ngriti një propozim, unë e kuptoj që mesazhi që duhet të dalë nga kjo mbledhje, përveç miratimit të këtij programi do të jetë edhe kjo pikë, pra që brenda një periudhe të ardhshme, maksimumi në korrik, do të organizohet një tavolinë e gjerë me të gjithë aktorët politikë pavarësisht se vjen apo jo eksperti. Eksperti do të vijë më vonë, do të paraqesë një projekt apo disa modele pasi të ketë bërë kontaktet dhe të ketë analizuar elementet sistematike në Shqipëri, pra si ka funksionuar sistemi zgjedhor, cilat janë modelet, eksperiencat e vitit 2008, etj.

Në do të bëjmë një njoftim për shtyp ku do të dalë që komisioni vendosi që brenda korrikut do të mbajë tavolinën e parë të gjerë, ku të gjithë aktorët e interesuar të jenë pjesë.

Ne mund ta vendosim edhe me njëri-tjetrin, se, në fund të fundit, ajo që tha Bashkimi është shumë e vërtetë, nuk është çështja t'ia imponojmë njëri-tjetrit. Unë them që me këtë japim mesazhin e duhur dhe fillojmë punën.

A jeni dakord që ta miratojmë programin, përfshirë dhe këtë?

E hedhim në votë.

Kush është dakord?

Miratohet.

Doja t'ju informoja për diçka: bashkë me zonjën Hajdaraj kemi zhvilluar takime me disa ambasadorë të huaj për të kërkuar mbështetje financiare për projektin tonë, ku shpresojmë të kemi një mbështetje për ekspertizë për çështjen e financimit të partive politike nga Britania, me qëllim që realizojmë një produkt të mirë për to.

Këto kisha unë, nuk kam gjë tjetër.

Rudina Hajdari – Besoj se edhe tryezat duhet të kenë efekte financiare, kështu që mendoj se do t'i bisedojmë me bashkëkryetarin.

Damian Gjijnuri - Të bëhet njoftimi shkurtimisht që u miratua, si dhe mesazhi se do të hapet diskutimi për sistemin zgjedhor.

Rudina Hajdari – A jeni dakord që tryeza të ketë disa faza, se nuk mund të jetë vetëm një fazë?

Damian Gjijnuri – Formulimi do të jetë i tillë: “Komisioni i Reformës Zgjedhore vendosi që të hapë diskutimet për çështjet e sistemit zgjedhor, duke filluar së pari me organizimin e një tryeze të gjerë jo më vonë se korriku i këtij viti”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, tryezë e gjerë me të gjithë aktorët e interesuar politikë, përfshirë dhe Ralf Gjjonin, i cili është entitet politik më vete.

Këtu po e mbyllim mbledhjen

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA